



Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosova Association of the Blind
Udruženje Slepih Kosova

SHOQATA E TË VERBËRVE E REPUBLIKËS KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA ASSOCIATION OF THE BLIND
UDRUŽENJE SLEPIH REPUBLIKE KOSOVA
Nr. 124/21
Dt. 30.09.2021
PRISHTINE

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodi i Sjelljes

Shoqata e të verbërve të Kosovës (SHVK)

POLITIKA E MBROJTJES SË FËMIJËVE

Përmbledhje ekzekutive

SHVK është vazhdimësi e lidhjes së të verbërve të Kosovës e themeluar në vitin 1947 dhe e rioragnizuar në vitin 2003.

SHVK është organizatë jo qeveritare, jo profitabile e regjistruar pranë institucionave përkatëse, e cila angazhohet për mbrojtjen, përfaqësimin dhe afirmimin e interesave dhe të drejtave të qytetarëve të verbër, pa dallim moshe, gjinie, përkatësie etnike dhe fetare.

SHVK, angazhohet në vazhdimësi për zbatueshmëri të plotë të ligjit për të verbër (04/L-092)

Si rrjedhojë, integrimi i personave të verbër në jetën publike dhe aftësimi i tyre për jetë të pavarur është një nga sfidat më të mëdha dhe synimi kryesor i SHVK.

Politikat zhvillimore të SHVK fokusohen edhe në faktorizimin e çështjeve që kanë të bëjnë me personat e verbër, dhe vetëdijësim të qytetarëve për përkrahje ndaj tyre. Këto politika implementohen përmes fushatave avokuese, debateve publike, konferencave, publikimeve të ndryshme, etj.

SHVK bashkëpunon me organizatat simotra, institucionet publike dhe me palët e tjera me interes me qëllim që të arrihen rezultate të kënaqshme, duke qenë në koordinim dhe përputhshmëri me organizmat dhe politikat të cilat aprovohen. SHVK në cilësinë e vëzhguesit merr pjesë në të gjitha takimet që organizohen nga Unionin Evropian i të verbërve, Komiteti Konsultativ Ballkanik i të verbërve dhe Unioni i të verbërve të Botës.

SHVK vepron në gjithë territorin e Kosovës, përmes rrjetit të saj të përbërë nga gjashtë shoqata nder komunalë dhe shtatë shoqata komunale. Shoqata ka organet e veta legjitime të zgjedhura në mënyrë demokratike. SHVK ka Kuvendin si organ vendimmarrës, kryetarin, këshillin drejtues dhe këshillin e përgjithshëm.

Departamenti për Ofrimin e Shërbimeve dhe Resurseve Njerëzore

SHVK në vitin 2012 ka themeluar Departamenti për ofrimin e shërbimeve specifike profesionale. Duk pasur parasysh, në mos përmbushjen ligjore për ofrimin e këtyre shërbimeve nga ana Institucioneve relevante shtetërore, SHVK ka marr për sipër që, shërbimet në fjalë t'i aplikoj falë ngritjeve të kapaciteteve njerëzore për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Shërbimet kryesore që ofron ky departament janë:

1. Shërbimet në Teknologjinë Informativë Asistuese
2. Shërbimet në shkrim dhe lexim në Breill;
3. Orientim në Hapësirë, Mobilitet dhe Shkathhtësi ditore dhe
4. Shërbime Psikosociale

Të gjitha shërbimet që ofrohen ky departament për ofrimin e shërbimeve profesionale, bëhen paraprakisht bazuar në nevojat e komunitetit, të identifikuara përmes Shoqatave komunale dhe nderkomunale. Kjo qendër ka drejtorinë, koordinatorët për çdo sferë të shërbimeve dhe trajnerët e certifikuar për ofrimin përkatëse.

Departamenti për Ofrimin e Shërbimeve posedon paisjet e duhura për ofrimin e shërbimeve të lartë përmendura, të cilat janë të donuara nga Agjensioni Çek për Zhvillim.

Vizioni

Personat e verbër, qytetar të barabartë, të pavarur dhe kontribues në shoqëri.

Misioni

Ne përfaqësojmë personat e verbër duke kontribuar në socializim, edukim, punësim dhe rehabilitim, duke u angazhuar dhe besuar në gjithë përfshirje dhe pavarësim të tyre.

Vlerat dhe parimet

- Struktura e organizatës e shtrirë në gjithë vendin
- Gjithë përfshirja e të gjitha etnive në vend
- Partneriteti kombëtar dhe ndërkombëtar
- Puna ekipore
- Llogaridhënia
- Transparenca
- E drejta ligjore për përfaqësim
- Përgatitja specifike profesionale

- Çdo person ka të drejtën e bashkimit për promovimin e të drejtave, lirisë dhe interesave të tij/saj.
- Çdo person i verbër ka të drejtë të eksploroj potencialin e tij dhe talentin për pjesëmarrje në komunitet
- Çdo person ka të drejtën për punësim, pjesëmarrje politike, lëvizshmëri dhe drejtësi sociale pa diskriminim
- Çdo grua dhe fëmijë i verbër ka të drejtën për arsim dhe mbrojtjen nga diskriminimin, ngacmimi seksual dhe abuzimi

Prishtinë, Dhjetor 2019

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodi i Sjelljes

Shoqata e të verbërve të Kosovës

1. Ndërgjegjësimi dhe Parandalimi

PËRHAPJA DHE RITJA E NDËRGJEGJËSIMIT

1.1 Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve ka për qëllim:

- a) të rrisë ndërgjegjësimin brenda organizatës, mbi fenomenin e abuzimit ndaj fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi;
- b) të përcaktojë procedurat standarde të veprimit në rastet kur parandalohen, ngrihen, raportohet , vlerësohet dhe reagohet ndaj problemeve të abuzimit me fëmijë;
- c) të ulë rrezikun e abuzimit ndaj fëmijëve përmes rekrutimit të sigurtë dhe aftësisimit të stafit në identifikim dhe raportim të shqetësimeve apo dyshimeve për abuzim;
- d) të sigurojë se fëmijët e dinë se dëgjohej dhe mund të shprehin shqetësimet e tyre në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale, dhe se marrin mbështetjen e duhur brenda organizatës.

1.2 Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve, Kodi i Sjelljes, dhe Procedurat Standarde të Veprimit duhet të vihen në dispozicion të gjerë për të gjithë personelin, përfaqësuesit e tjerë, prindërit, kujdestarët ligjorë dhe fëmijët, personelin e agjencive partnere dhe profesionistëve të tjerë, që angazhohen në ndonjë mënyrë pranë SHVK-së..

1.3 Shpërndarja duhet të mbështetet aq sa për të siguruar që janë kuptuar Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Kodi i Mirësjelljes: kjo përfshin përkthimin në gjuhët zyrtare, prezantimin, trajnimin, posterët, deklaratat e SHVK-së mbi zotimin për mbrojtjen e fëmijëve, imazhet dhe materialin miqësor për fëmijët.

REKRUTIMI DHE SELEKSIONIMI

1.4 Rekrutimi dhe seleksionimi i personelit dhe të tjerëve duhet të pasqyrojë angazhimin e SHVK-së për të mbrojtur fëmijët, duke u siguruar se paralajmërimet, kontrollet dhe procedurat për t'i shmangur të gjithë ata që mund të jenë të papërshtatshëm për të punuar me fëmijët, janë funksionale.

1.5 SHVK përkujdeset dhe angazhohet që në të gjitha shpalljet, konkurset për rekrutimin e stafit/vullnetarëve/praktikantëve/kompanive/konsulentëve, të bëjë të qartë përgjegjësinë e tyre për zbatimin e politikës për mbrojtjen e fëmijëve.

1.6 Të gjithë personave që do të punësohen, veç kontratës së punës dhe përshkrimit të detyrave do tu kërkohet dhe do tu bashkangjitet në dosjen e tyre të punës edhe:

- 1) Një kopje e një dokumenti identifikues (pasaportë / kartë identiteti)
- 2) Dëshmia e penalitetit nga gjykata dhe deklarata që nuk është nën hetime nga Policia
- 3) Deklarata e nënshkruar mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve
- 4) Curriculum Vitae
- 5) Rregullorja e Brendshme e nënshkruar
- 6) Dy referenca të verifikuara nga dy punëdhënësit e kaluar (nëse është e aplikueshme);

Dokumentacioni që do të dorëzohet nga personat e tjerë që do të angazhohen në organizatë, do të vlerësohet nga vetë zyra menaxhuese në bazë nivelit të kontaktit që ata do të kenë me fëmijët.

1.7 Kandidatët e suksesshëm duhet të vetëdijësohen për natyrën themelore dhe të detyrueshme të kësaj politike, procedurat dhe kodin e mirësjelljes dhe për faktin që ato zbatohen në mënyrë të barabartë në jetën personale dhe profesionale.

STRUKTURIMI I MBROJTJES SË FËMIJËVE NE SISTEMET DHE PROCESET E MENAXHIMIT

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodi i Sjelljes

SHVK

1.8 Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve duhet të përfshihet në të gjitha sistemet dhe proceset që kanë ndonjë ndikim në mbrojtjen e fëmijëve, në mënyrë që të krijohet një mjedis ku respektohen të drejtat e fëmijëve dhe ku nuk tolerohet abuzimi i fëmijëve.

1.9 Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve duhet të reflektohet në të gjitha marrëveshjet e burimeve njerëzore dhe të menaxhimit që përcaktojnë se si personeli dhe përfaqësuesit e tjerë kryejnë punën e tyre, duke përfshirë përshkrimet e punës të shpallura, Procedurat Standarde të Veprimit, referencat, kontratën e punës, kodin e sjelljes, sistemet e vlerësimit të performancës dhe procedurat disiplinore. Dështimi për t'ju përmbajtur aspekteve për mbrojtjen e fëmijëve të cilësdo marrëveshje të tillë, duhet të njihet si shkelje e rëndë disiplinore.

1.10 Fëmijët dhe kujdestarët e tyre duhet të bëhen të vetëdijshëm për sistemet ekzistuese për të ngritur një shqetësim ose një ankesë. Si aktorë kryesorë duhet të jenë në dijeni të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Kodit të Mirësjelljes dhe për atë se çka ata mund të presin në kuptim të sjelljes së personelit, të përfaqësuesve të tjerë dhe partnerëve ndaj tyre. Materialet miqësore të fëmijëve duhet të përdoren për të komunikuar këto mesazhe.

1.11 Aty ku SHVK është përgjegjëse për ofrimin e veprimtarive apo shërbimeve për fëmijët, ata në çdo kohë do ti mbikëqyrin dhe mbrojnë ata sipas aftësive më të mira. Cilësia e këtyre shërbimeve dhe aktiviteteve duhet të reflektojnë parimet dhe procedurat e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve.

1.12 Në rast të raportimit të ndonjë rasti të abuzimit nga një fëmijë, qoftë si viktimë apo dëshmitar në rast, cilido anëtar i stafit të cilit i raportohet abuzimi, duhet që në **MËNYRË TË MENJËHERSHME** të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- të sigurojë që fëmija të vendoset në një ambient të sigurt, të ngrohtë e pa rreziqe;
- të sigurojë që fëmija nuk është i uritur, i etur dhe që është i veshur në mënyrë dinjitoze;
- të informojë menjëherë supervizorin/menaxherin dhe koordinatorin për mbrojtje të fëmijës;
- të vijojë më pas me zinxhirin e raportimit sikurse është cekur në Politikën e Mbrojtjes së Fëmijës.

VLERËSIMI I RREZIKUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT

1.13 Të gjitha aktivitetet, përfshirë edhe kontaktin me fëmijët përmes përdorimit të teknologjive të informacionit, duhet të vlerësohen brenda SHVK dhe duhet të merret pëlqimi i prindërve me shkrim, për të siguruar që janë identifikuar të gjitha rreziqet për mbrojtjen e fëmijëve dhe se janë zhvilluar kontrollet e duhura. Këto aspekte duhet të përfshihen në kuadër të Monitorimit dhe Vlerësimit për aktivitete të tilla.

MBROJTA E FËMIJEVE NË MEDIA

1.14 Angazhimi me fëmijët dhe kujdestarët e tyre për qëllime të marketingut, medias / komunikimit, pjesëmarrjes dhe avokimit duhet të bëhet me pëlqimin e informuar dhe me shkrim të prindit /

kujdestarit, dhe nuk duhet ta shfrytëzojë fëmijën ose kujdestarin, e as ta rrisë ndjeshmërinë e tyre, apo ti vërë ata në rrezik. Duhet të zhvillohen kontrole adekuate për aktivitete të tilla dhe të ndiqen udhëzimet e identifikuara praktike.

Për këtë qëllim, SHVK do të krijojë forma të tjera mbështetëse duke përfshirë formën e pëlqimit me shkrim nga prindi, në të cilat do të specifikohen arsyet e kërkesës për pëlqim, përdorimi i angazhimit përkatës dhe garancia fëmija dhe integriteti i saj/tij nuk do të cënohet/rrezikohet.

MËSIMI DHE ZHVILLIMI

1.15 Për të zhvilluar shkathtësitë e mbrojtjes së fëmijëve si dhe njohuritë dhe eksperiencën e duhur për rolin e tyre në organizatë, personeli, përfaqësuesit dhe personeli i agjencive partnere duhet të mbështetet. Personeli që e ka përgjegjësi që të përgjigjet për fëmijët që zbulojnë abuzimin dhe shfrytëzimin seksual, duhet të marrë trajnim të veçantë në pranimin dhe përgjigjen ndaj zbulimit.

1.16 Koordinatori për Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve në bashkëpunim me stafin harton planin vjetor për ngritjen e kapaciteteve për implementimin e Mbrojtjes së Fëmijëve.

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodi i Sjelljes

SHVK

1.17 Të kuptuarit e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve (duke përfshirë Kodin e Sjelljes dhe Procedurat bazuar në legjislacionin në fuqi) duhet të përfshihen në prezantimin dhe trajnimin e detyrueshëm/bazë për personelin dhe përfaqësuesit e tjerë. Ndjeshmëria për dhe të kuptuarit e rrethanave locale dhe kulturës duhet të përfshihen në të mësuar dhe në trajnim, pa i falur aktet që janë të dëmshme për fëmijët.

1.18 Secili punëmarrës/vullnetar/praktikant duhet ti nënshtrohet trajnimit të obligueshëm për Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve, brenda javës së parë pas punësimit/angazhimit.

1.19 SHVK do të organizojë së paku një trajnim në vit, për stafin, lidhur me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve.

PARTNERËT

1.20 Të gjitha marrëveshjet në mes të SHVK-së dhe organizatave partnere, duhet të përfshijnë edhe marrëveshjen për Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve.

1.20 Agjencitë partnere duhet ta miratojnë këtë Politikë të Mbrojtjes së Fëmijëve ose ta zhvillojnë politikën e tyre të një standardi dhe qasjeje të ngjashme. Marrëveshjet me partnerët duhet qartë të përshkruajnë procedurat e dakorduara për raportimin dhe hetimin e shqetësimeve që përfshijnë shkeljet e politikës. Organizatat me të cilat SHVK-së ka marrëveshje partneriteti duhet të raportojnë tek SHVK, për shkeljet që ndodhin në kuadër të pikave të marrëveshjes.

1.21 SHVK duhet të ketë plane të qarta për zhvillimin e kapaciteteve të SHVK në nivel lokal për të zhvilluar politika dhe procedura të bazuara në standarde, duke shfrytëzuar burimet e zhvilluara në SHVK.

TEKNOLOGJITË E INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT

1.22 Rregulloret dhe politikat e SHVK duhet të rregullojnë përdorimin e duhur të teknologjive të informimit dhe komunikimit të tilla si interneti, faqet e internetit, faqet e rrjeteve sociale, fotografitë

dixhitale ku kërkohet që të bëhet një vlerësim rreziku, për të siguruar se fëmijët nuk janë vënë në rrezik.

Rregulloret dhe politikat e SHVK duhet të mbulojë edhe përdorimin e këtyre teknologjive nga personeli ynë dhe përfaqësuesit, si dhe fëmijët që shfrytëzojnë teknologjitë në emër tonë ose në përgjigje të një kërkesë nga organizata jonë.

SJELLJA NDAJ FËMIJËVE

1.23 Personeli, partnerët, vullnetarët, praktikantët dhe përfaqësuesit e tjerë nuk duhet asnjëherë të:

1. Godasin ose në ndonjë mënyrë tjetër fizike t'i sulmojnë apo t'i abuzojnë fëmijët.
2. Përfshihen në aktivitet seksual ose të kenë marrëdhënie seksuale me askënd nën moshën 18 vjeç, pavarësisht nga mosha, pëlqimi i viktimës /pëlqimi i prindërve apo të tjerëve/ tradita lokale. Perceptimi i gabuar për moshën e një fëmije nuk përbën arsyetim për mbrojtje.
3. Zhvillojnë marrëdhënie me fëmijë të cilat në cfarëdo mënyre mund të konsiderohen si shfrytëzuese apo abuzive.
4. Të veprojnë në mënyra që mund të jenë abuzive në ndonjë mënyrë ose mund të vendosin fëmijën në rrezik nga abuzimi.
5. Përdorin gjuhën, të bëjnë sugjerime ose të ofrojnë këshilla të cilat janë të papërshtatshme, ofenduese apo abuzive.
6. Sillen fizikisht në një mënyrë që është e papërshtatshme ose seksualisht provokuese.
7. Marrin fëmijën / fëmijët me të cilët ata janë duke punuar për të qëndruar gjatë natës në shtëpinë e tyre.
8. Flenë në të njëjtin shtrat me fëmijën me të cilët ata janë duke punuar.
9. Flenë në të njëjtën dhomë me fëmijën me të cilin ata janë duke punuar.
10. Bëjnë gjëra të natyrës personale për fëmijët të cilat ata mund ti bëjnë vetë.

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodi i Sjelljes

SHVK

11. Nuk mund të rrinë në ambient/dhomë të mbyllur vetëm me një fëmijë. Si alternative mund të lihet dera hapur, vendosja e dritareve apo derës transparente, apo në ambient të jetë i pranishëm edhe një person tjetër i rritur.

12. Tolerojnë, ose të marrin pjesë në sjelljen e fëmijëve e cila është e paligjshme, e pasigurt ose abuzive.

13. Veprojnë në mënyra të qëllimshme për ti turpëruar, nënçmuar ose degraduar fëmijët, ose për të ushtruar ndonjë formë të abuzimit emocional.

14. Diskriminojnë, tregojnë trajtim të padrejtë ose diferencial mes fëmijëve të caktuar duke i përjashtuar të tjerët.

15. Kalojnë kohë të tepërt vetëm me fëmijët larg nga të tjerët.

16. Vënë veten në një pozicion ku ata bëhen të ndjeshëm për pohimet për shkelje.

Kjo nuk është një listë përfundimtare ose ekskluzive. Personeli, partnerët dhe përfaqësuesit e tjerë duhet gjatë gjithë kohës të shmangin veprimet ose sjelljet të cilat mund të lejojnë që sjellja të keqinterpretohet, të përbëjë praktikë të dobët apo sjellje potencialisht abuzive.

1.24 Është e rëndësishme për të gjithë personelin, partnerët dhe përfaqësuesit e tjerë në kontakt me fëmijët të:

- a. Jenë të vetëdijshëm për situatat që mund të paraqesin rrezik dhe ti menaxhojnë ato.

- b. Planifikojnë dhe organizojnë punën dhe vendin e punës në mënyrë që të minimizojnë rreziqet.
- c. Jenë të dukshëm në punën me fëmijët për aq sa është e mundur.
- d. Sigurohen që ekziston një kulturë e hapur për të mundësuar çfarëdo çështjesh apo shqetësimesh të ngrihen dhe diskutohen.
- e. Sigurohen që ekziston llogaridhënia midis personelit në mënyrë që praktika të varfra apo sjellje potencialisht abuzive nuk kalojnë pa u trajtuar.
- f. Bisedojnë me fëmijët rreth kontaktit të tyre me personelin ose të tjerët, në mënyrë që ti inkurajojnë ata për të ngritur ndonjë shqetësim potencial.
- g. Fuqizojnë fëmijët - të diskutojnë me ta për të drejtat e tyre, çka është e pranueshme dhe e papranueshme, dhe çka mund të bëjnë ata nëse ka ndonjë problem.
- h. Ruajnë standardet e larta personale dhe profesionale.
- i. Respektojnë të drejtat e fëmijëve dhe ti trajtojnë ata në mënyrë të drejtë, me ndershmëri, me dinjitet dhe respekt.
- j. Inkurajojnë praktikën e pjesëmarrjes me fëmijët, që zhvillon kapacitetet e mbrojtjes së tyre.

2. Raportimi dhe Përgjigja

SISTEMI I CENTRALIZUAR

2.1 SHVK do të krijojë një sistem të centralizuar, në mënyrë që shqetësimet e identifikuara dhe të cilave u është dhënë përgjigje në nivel lokal të raportohen, regjistrohen dhe analizohen në mënyrë të centralizuar. Këto shënime duhet të raportohen tek menaxherët e lartë në baza të rregullta.

PROCEDURA E RAPORTIMIT

2.2 Në kuadër të kësaj politike, është zhvilluar Procedura e raportimit e cila përshkruan në detaje zinxhirin e veprimeve që do të ndiqen kur është ngritur shqetësimi (shih shtojcën). Procedura e raportimit duhet të dallojë në mes incidenteve të cilat e kanë origjinën e tyre jashtë organizatës, ato të cilat përfshijnë personelin, përfaqësuesit e tjerë dhe partnerët, si dhe ato ku autorët e dyshuar janë vetë fëmijët.

2.3 Kjo politikë parasheh edhe Procedurën e raportimit me udhëzimet e dakorduara të menaxhimit lidhur me kur dhe si ti raportojnë shqetësimet tek autoritetet kombëtare të tilla si Policia ose Ministrinë / Autoritetet lokale /kombëtare (për shembull ku është kryer një vepër e supozuar). Përveç kësaj ato do të përfshijnë infrastrukturën dhe burimet lokale të mbrojtjes së fëmijëve, të cilat janë në dispozicion.

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodi i Sjelljes

SHVK

DETYRA E GJITHË PERSONELIT DHE PËRFAQËSUESVE TË TJERË PËR TË RAPORTUAR SHQETËSIMET

2.4 I gjithë personeli i SHVK, përfaqësuesit e tjerë dhe personeli i partnere duhet t'i raportojnë të gjitha shqetësimet duke përfshirë edhe raportet specifike edhe shqetësimet e pakonfirmuara lidhur me abuzimin e fëmijëve ose shfrytëzimin seksual, ku autori i dyshuar është anëtar i personelit, përfaqësues tjetër ose personel i organizatës partnere.

2.5 Prioritet i parë i çdo anëtar i të personelit të cilit i janë raportuar shqetësimet për mbrojtjen e

fëmijëve duhet të jetë siguria dhe mirëqenia e menjëhershme e fëmijës (sikurse janë listuar në paragrafin 1.12 të këtij dokumenti).

2.6 Kjo politikë përfshin edhe procedurat që i mundësojnë personelit për të raportuar dhe për t'iu përgjigjur akuzave të rënda të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual ku autorët e dyshuar shtrihen jashtë organizatës, përfaqësuesve të saj ose partnerëve (shih shtojcën).

2.7 Sipas kësaj politike, shqetësimet për mbrojtjen e fëmijëve duhet të raportohen menjëherë, përveç nëse është e pamundur apo jopraktike për të bërë këtë apo ekzistojnë rrethana të tjera të veçanta.

2.8 Procedurat duhet të jenë lehtësisht të arritshme, të njohura dhe të kuptuara nga i gjithë personeli, përfaqësuesit dhe personeli e agjencive partnere.

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË PËR ZBATIMIN E POLITIKËS SË MBROJTJES SË FËMIJËVE

2.9 "Koordinatorët për Mbrojtjen e Fëmijëve" në nivel komunal, p.sh. anëtarët e caktuar të personelit për të pranuar shqetësimet / ankesat për Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të emërohen nga shumica e stafit të punësuar, në komuna.

2.10 "Koordinatori për Mbrojtjen e Fëmijëve" në nivel nacional, p.sh. anëtarët e caktuar të personelit për të pranuar shqetësimet / ankesat për Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të emërohen nga shumica e stafit të punësuar.

2.11 Personeli i nominuar si Koordinator për Mbrojtjen e Fëmijëve duhet ta ketë qartë të identifikuar rolin dhe përgjegjësinë e tyre në Mbrojtjen e Fëmijëve. Kjo duhet të përfshijë rolet dhe përgjegjësitë e personelit në ngritjen e shqetësimeve / ankesave të Mbrojtjes së Fëmijëve, pikat e kontaktit në mbrojtjen e fëmijëve për pranimin e shqetësimeve / ankesave dhe menaxherët për t'iu përgjigjur dhe menaxhuar këto çështje. Roli dhe përgjegjësitë e tij/saj duhet të paraqiten qartë në përshkrimin e tij/saj të punës.

2.12 Koordinatori për Mbrojtjen e Fëmijëve ka për detyrë:

- Koordinon procesin e hartimit të planin e veprimit për zbatimin dhe monitorimin e planit të veprimit për politikën për mbrojtjen e fëmijëve.
- Të sigurojë se i gjithë stafi merr trajnimin e nevojshëm mbi Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve.
- Të presë e të ndërmarrë veprime në bazë të raporteve nga stafi.
- Të mbajë të dhëna mbi hapat e marra në lidhje me çështje të mbrojtjes së fëmijëve.
- Të referojë rastin në organet përkatëse.
- Të marrë trajnimet e nevojshme e të vazhdueshme për mbështetje në këtë drejtim.

2.13 I gjithë personeli, përfaqësuesit, dhe personeli i agjencive partnere duhet të jenë të vetëdijshëm për detajet e pikës së kontaktit për pranimin e shqetësimeve / ankesave të mbrojtjes së fëmijëve.

2.14 Forma standarde e raportimit duhet të përdoret për raportimin e shqetësimeve (Shih shtojcën - Forma për Raportimin e Mbrojtjes së Fëmijës).

PARIMET DHE PRAKTIKA NË PËRGJIGJE TË AKUZAVE PËR ABUZIME APO SHFRYTËZIM SEKSUAL

2.15 Në përgjigje ndaj akuzave të abuzimit të fëmijëve apo shfrytëzimit seksual të fëmijëve, personeli dhe menaxherët duhet të udhëzohen nga Procedura e Raportimit. Këto e përcaktojnë një grup të qartë të parimeve që përqëndrohen në interesin më të lartë të fëmijës, si dhe çështjet e mbrojtjes dhe

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodi i Sjelljes

SHVK

të sigurisë, shëndetin dhe mirëqenien fizike dhe psikologjike dhe respektin për të drejtën e konfidencialitetit, barazisë dhe qasjes në drejtësi.

2.16 gjithë personeli i SHVK, përfaqësuesit e të tjerë dhe partnerët veprojnë në mënyrë të përshtatshme dhe efektive në procesin e vlerësimit dhe udhëhiqen nga parimi i veprimit në “interesin më të lartë të fëmijës” në çdo proces të tillë.

2.17 Personelit i kërkohet që të bashkëpunojë në çdo vlerësim të rastit dhe të ruajë nivelet e duhura të konfidencialitetit. Dështimi për ta bërë këtë konsiderohet një shkelje e rëndë disiplinore.

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E PERSONELIT NË PËRGJIGJEN NDAJ POHIMEVE PËR ABUZIM DHE SHFRYTËZIM SEKSUAL

2.18 Personeli dhe menaxherët duhet të jenë të vetëdijshëm për rolet dhe përgjegjësitë e tyre (shih 1.23 dhe 1.24) pjesën ndaj përgjigjes, vlerësimit dhe referimit të pohimeve për abuzim dhe shfrytëzim seksual tek autoritetet kombëtare siç përshkruhet në procedurat e raportimit (shih shtojcën për raportimin).

SISTEMET MENAXHESE PËR TU PËRGJIGJUR, MENAXHUAR DHE PËR TË MËSUAR NGA INCIDENTET

2.19 SHVK duhet të krijojë sistem të menaxhimit të aftë për të menaxhuar një incident duke mbështetur dhe ndihmuar viktimat dhe duke nxjerrë mësim si rezultat i ngjarjes, raportimit, vlerësimit apo menaxhimit të çdo incidenti në bazë të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve në mënyrë që të nxirren mësimet dhe të përmirësohen praktikat.

2.20 Mësimet e nxjerra në zbatimin e përgjithshëm të kësaj Politike, si dhe nga incidentet individuale duhet të përdoren për të influencuar politikën dhe për zhvillimin e praktikave më të mira në SHVK dhe gjetiu kur është e përshtatshme.

2.21 gjithë personeli dhe përfaqësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se çdo shqetësim apo pretendim për abuzim apo shfrytëzim të fëmijëve, i ngritur kundër tyre do të vlerësohet, në bazë të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve:

- a. duke shqyrtuar referimin tek autoritetet ligjore për hetimin dhe ndjekjen penale sipas legjislacionit vendor, kur pretendimi është një shkelje e mundshme e ligjit dhe / ose
- b. nga SHVK, në përputhje me Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve, Rregulloret dhe sipas procedurave disiplinore, të cilat mund të rezultojnë me shkarkim.

PROCEDURAE RAPORTIMIT

Secili anëtar i stafit i cili është i shqetësuar për sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës, dyshon apo zbulon një abuzim, obligohet ta trajtojë këtë çështje me **PRIORITET ABSOLUT** dhe ta raportojë rastin përmes plotësimit të Formës së Raportimit për Mbrojtje të Fëmijës dhe dorëzimit tek Koordinatori përkatës për Mbrojtjen e Fëmijës apo personat e tjerë kontaktues të përcaktuar në Procedurën e Raportimit.

Koordinatori i Mbrojtjes së Fëmijëve ka për detyrë të koordinojë përgjigjen ndaj rastit të abuzimit të fëmijëve, në përputhje me procedurat standarde të veprimit, politikat, rregulloret dhe duke patur në konsideratë primare **INTERESIN MË TË LARTË TË FËMIJËS**.

Në raste të tilla, duhet ndjekur rigorozisht procedura e mëposhtme:

Cilat janë rrethanat e shqetësimit tuaj?

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodi i Sjelljes
SHVK

A keni qenë dëshmitar i abuzimit të fëmijëve? Po / Jo

A dyshoni se dikush ka abuzuar me fëmijët? Po / Jo

A ka abuzuar dikush me një fëmijë? Po / Jo

A ju ka thënë dikush për abuzimin e një fëmije? Po / Jo

A keni shqetësime për ndonjë nga kategoritë e mëposhtme të abuzimit?

A mendoni se një fëmijë mund të ketë qenë lënë pas dore? Po / Jo

A mendoni se një fëmijë mund të ketë qenë abuzuar fizikisht? Po / Jo

A mendoni se një fëmijë mund të ketë qenë abuzuar emocionalisht? Po / Jo

A mendoni se një fëmijë mund të ketë qenë abuzuar seksualisht? Po / Jo

Shqetësimi juaj është i justifikuar nëse ju përgjigjeni po në ndonjë nga pyetjet e mësipërme, detyra juaj është që menjëherë t'i njoftoni shqetësimet tuaja te njëri nga personat e mëposhtëm duke plotësuar Formën e Raportimit për Mbrojtje të Fëmijës.

Mos vononi - një fëmijë mund të rrezikohet nga ndonjë dëm serioz nëse nuk veproni!

Personi kontaktues:

Emri:

Titulli: Koordinator Lokal i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve / Një person përgjegjës për zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve

Vendndodhja:

Telefoni:

E-mail:

Nëse keni shqetësime në lidhje me informimin e personit në këtë kuti ju lutemi të ndihuni të lirë të informoni personat në kutitë e mëposhtme.

Personi kontaktues:

Emri:

Titulli: Koordinator Nacional i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve / Personi kyç përgjegjës për zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve

Vendndodhja:

Telefoni:

E-mail:

Personi kontaktues:

Emri:

Titulli: Drejtor Ekzekutiv

Vendndodhja:

Telefoni:

E-mail:

Ky person do të shqyrtojë informacionin dhe, nëse konsiderohet e nevojshme, të miratojë hapa emergjentë dhe një plan veprimi me afatet dhe përgjegjësitë për këtë fushë.

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodi i Sjelljes

SHVK

Personi kontaktues:

Emri:

Titulli: Anëtarët e Bordit (ndonjë nga pesë / shtatë anëtarë të bordit ekzekutiv ose të gjithë ata)

Vendndodhja:

Telefoni:

E-mail:

Ky person do të shqyrtojë informacionin dhe, nëse konsiderohet e nevojshme, të miratojë hapa emergjentë dhe një plan veprimi me afatet dhe përgjegjësitë për këtë fushë.

Shënim: Nëse ka arsye për mos raportimin e rastit tek personat në kutitë e mësipërme, çdo person duhet të raportojë shqetësime tek autoritetet publike të shtetit, përmes zinxhirit të jashtëm të raportimit.

ZINXHIRI I JASHTËM I RAPORTIMIT

Policia e Kosovës;

- Emri:
- Titulli:
- Komuna:
- Telefoni:
- E-mail:

Qendra për Punë Sociale:

- Emri:
- Titulli:
- Komuna:
- Telefoni:
- E-mail:

Mbrojtësit e viktimave;

- Emri:
- Titulli:
- Komuna:
- Telefoni:
- E-mail:

Dështimi për të raportuar abuzimin e fëmijëve:

Bazuar në Kodin Penal të Kosovës, Neni 254 Dështimi për të raportuar abuzimin e fëmijëve:

1. Pavarësisht nga dispozitat e tjera të ligjit, kushdo që ka arsye të dyshojë se një fëmijë ka pësuar një incident të keqtrajtimit, keqtrajtimit, braktisjes ose neglizhimit të fëmijës dhe nuk e njofton menjëherë abuzimin ose neglizhimin, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga një prind, një prind adoptues ose kujdestar dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

3. Kushdo që, kur është i angazhuar në një aftësi profesionale në lidhje me fëmijën, ka arsye të dyshojë se një fëmijë ka pësuar një incident të keqtrajtimit, keqtrajtimit, braktisjes ose Politika për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodi i Sjelljes

SHVK

neglizhimit të fëmijës, ose është nënshtruar dhunës ose kërcënimit të dhunës dhe nuk raporton menjëherë dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

4. Kur vepra penale nga paragrafët 1, 2 ose 3 të këtij neni rezulton me vdekjen e fëmijës ose dëmtim të rëndë të shëndetit të tij, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodi i Sjelljes

SHVK

FORMA E RAPORTIMIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

Nëse dikush (fëmijë, prind/kujdestar, anëtar i stafit, person tjetër i angazhuar, staf i organizatave partnere, etj) ngre një shqetësim apo denoncim, forma e mëposhtme duhet plotësuar duke ruajtur detajet për çka është thënë dhe ku është bërë denoncimi. Ju lutem vazhdoni në pjesën e prapme të fletës nëse është e nevojshme. Ju lutem gjithashtu shënoni

nëse ndokush tjetër ishte prezent.

Data: Koha: Vendi:

Emri i personit referues / cilësia:

Anëtar i stafit të cilit i referohet shqetësimi:

Arsyet për shqetësim:

Referoi: Pranoi:

Nënshkrimi Nënshkrimi

Të plotësohet nga Koordinatorin për Mbrojtjen e Fëmijëve:

Vendimi:

Veprimet e ndërmarra:

Nënshkruar:

Koordinatorin për Mbrojtjen e Fëmijëve

Data: Koha: Vendi:

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodi i Sjelljes

SHVK

ABUZIMI NDAJ FËMIJËVE DHE FORMAT E TIJ

Fenomeni i abuzimit ndaj fëmijëve është një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve. Abuzimi ndaj fëmijëve jo vetëm që çënon rëndë integritetin e fëmijës por varësisht prej formës në të cilën ndodh, mundet të dëmtojë rëndë zhvillimin e fëmijës shpesh duke lënë pasoja afatgjata tek ta. Në trajtat më të vrazhda, abuzimi dëmton shëndetin fizik e mendor të fëmijës dhe pasojat e tij nëse nuk identifikohet e trajtohet me kohë, mund të çojnë madje deri në vdekje të fëmijës. Abuzimi është një dukuri e cila nuk ka asnjë mit. Perceptimet që ai ndodh në shoqëritë e pazhvilluara, në kohë apo epoka të mëparshme, apo perceptimet se ai dallon nga zonat rurale dhe urbane si dhe nga statusi i familjes, janë tërësisht të gabuara. Abuzime të fëmijëve kanë ndodhur në çdo kohë, ato janë shfaqur në të gjitha shoqëritë, kulturat e etapat historike, në familje me status të ndryshëm socio-ekonomik dhe nga individë të ndryshëm, pavarësisht profilit të tyre. Faktet dëshmojnë se abuzimi ka ardhur edhe nga individë punonjës të organizatave apo institucioneve që punojnë me fëmijët, prej të cilëve në fakt është pritur mbrojtja e tyre.

Në bazë të statistikave globale, rezulton se individët abuzues, priren të kërkojnë punësim në organizata apo institucione ku kanë kontakt me fëmijë. Në anën tjetër, statistikat tregojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara janë rreth tre herë më të rrezikuar për të qenë viktimë të formave të ndryshme të abuzimit, pasi në varësi të aftësisë së kufizuar, për ta mund të jetë më e vështirë të zbulojnë abuzuesin, të largohen nga vendngjarja, etj.

Në më të shumtën e rasteve, abuzimet mbulojnë për arsye të mungesës së informacionit, ndjenjës së fajit dhe ndjenjës së turpërimit për të raportuar rastin, frikës ndaj stigmatizimit, vetëdijes së ulët, etj. interesa të tjerë

Katër kategoritë universale të njohura të abuzimit të fëmijës janë:

- Abuzimi fizik

Dëmtimi real ose i mundshëm fizik i fëmijës ose dështimi në shmangien e dëmtimit ose vuajtjes fizike.

- Abuzimi emocional

Efektet negative reale ose të mundshme mbi zhvillimin dhe sjelljen emocionale të fëmijës të shkaktuara nga keqtrajtimi i vazhdueshëm ose i rëndë ose refuzimi. Të gjitha format e abuzimeve përfshijnë keqtrajtim emocional të fëmijës.

- Abuzim seksual

Shfrytëzimi real ose kërcënimi për shfrytëzim seksual të fëmijës, përfshirë këtu të gjitha format e aktivitetit seksual, të tilla si përdhunimi, incesti dhe pornografia.

• Neglizhimi

Lënia pas dore e vazhdueshme ose e rëndë e fëmijës ose dështimi në mbrojtjen e fëmijës nga ekspozimi ndaj çdo lloj rreziku, duke përfshirë të ftohtin dhe urinë, si dhe dështimi në dhënien e aspekteve të ndryshme të përkujdesjes që sjellin si pasojë dobësimin e shëndetit dhe zhvillimit të fëmijës.

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodi i Sjelljes SHVK

TABELA E ILUSTRUAR E RAPORTIMIT

Zinxhiri i brendshëm i raportimit të abuzimit

Anëtari i stafit është dëshmitar i abuzimit ose merr raportimin nga fëmija:

- 1- Sigurohet mirëqenia imediate e fëmijës në rast nevojë (ambient i sigurt, ushqim, veshmbathje)
- 2- Plotësohet Forma e Raportimit për Mbrojtjen e Fëmijës (shih formën si shtojcë)
- 3- Forma e plotësuar dorëzohet tek Koordinatori Lokal i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve
- 4- Forma e plotësuar dorëzohet tek Koordinatori Nacional i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve
- 5- Forma e plotësuar dorëzohet tek Drejtori Ekzekutiv i organizatës
- 6- Forma e plotësuar dorëzohet tek Bordi i organizatës

Zinxhiri i jashtëm i raportimit të abuzimit

Anëtari i stafit është dëshmitar i abuzimit ose merr raportimin nga fëmija:

- 1- Sigurohet mirëqenia imediate e fëmijës në rast nevojë (ambient i sigurt, ushqim, veshmbathje)
- 2- Plotësohet Forma e Raportimit për Mbrojtjen e Fëmijës (shih formën si shtojcë)
- 3- Raportohet te 3- Raportohet te Qendra 3- Raportohet te Policia e Kosovës për Punë Sociale Mbrojtësit e Viktimave

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodi i Sjelljes SHVK

KODI I SJELLJES I SHVK

PARIMET UDHËZUESE

1. Unë do t'i respektoj të tjerët:

Unë do t'i respektoj të drejtat themelore të të gjithë njerëzve pavarësisht gjinisë, aftësive të kufizuara, përkatësisë etnike, fesë, kastës, gjuhës, statusit HIV dhe aspekteve të tjera të identitetit. Unë do të veproj në mënyrë të drejtë, me ndershmëri dhe takt që t'i trajtoj njerëzit me dinjitet dhe respekt.

Unë nuk do të:

- marr pjesë në asnjë formë të diskriminimit, ngacmimit, apo abuzimit (fizik, seksual ose verbal), kërcënimit ose shfrytëzimit, ose në ndonjë mënyrë tjetër të shkeljes së të drejtave të të tjerëve.

3. Unë do të punoj në mënyrë aktive për të mbrojtur fëmijët:

Duke kryer përgjegjësinë time të veçantë për fëmijët, ndaj të cilëve SHVK ka për detyrë të kujdeset dhe të krijojë një mjedis të sigurt për fëmijët për të parandaluar abuzimin apo neglizhimin fizik, seksual, ose emocional ndaj tyre.

Unë nuk do të:

- veproj në asnjë mënyrë që shkel Politikën dhe Procedurat e SHVK për Mbrojtjen e Fëmijëve ose që në ndonjë mënyrë i vë fëmijët në rrezik të lëndimit.
- fsheh informacionin në lidhje me ndonjë dënim aktual penal, akuza ose procedura civile që kanë të bëjnë me abuzimin e fëmijëve, qoftë kur unë t'i bashkangjitem SHVK ose që ndodh gjatë kohës sime të punësimit.

3. Unë do të ruaj standarde të larta të sjelljes personale dhe profesionale:

Duke u përpjekur për standarde të larta në punën time, duke marrë përgjegjësinë për veprimet e mia dhe duke mos abuzuar me kompetencat e pozicionit tim si përfaqësues i SHVK, unë nuk do të sillem në asnjë mënyrë që dëmton aftësinë time për të kryer punën time ose që ka të ngjarë të diskreditojë SHVK.

Unë nuk do të:

- angazhohem në marrëdhënie seksuale me askënd nën moshën 18 vjeçare, apo abuzoj apo shfrytëzoj asnjë fëmijë në asnjë mënyrë.
- shkëmbej para, punësim, mallra ose shërbime për favore seksuale.
- konsumoj alkool ose përdor ndonjë substancë tjetër në asnjë mënyrë që ndikon në aftësinë time për të kryer punën time, ose që ndikon në reputacionin e organizatës.
- posedoj, e as nuk do të përfitoj nga shitja e mallrave apo substancave të paligjshme.
- kërkoj ose ftoj asnjë pagesë, shërbim apo favor personal nga të tjerët, veçanërisht nga përfituesit, në këmbim të ndihmës, mbështetjes, mallrave ose shërbimeve tona të çfarëdo lloji.
- pranoj mitmarrje apo dhurata të mëdha (me përjashtim të dhuratave të vogla të vlerësimit) nga qeveritë, përfituesit, donatorët, furnizuesit apo të tjerë të cilat janë ofruar si rezultat i punësimit tim.

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodi i Sjelljes
SHVK

- hyj në asnjë lloj marrëdhënie biznesi në emër të SHVK me familjen, miqtë ose kontaktet e tjera personale / profesionale për furnizimin e ndonjë malli apo shërbimi për SHVK apo për ndonjë çështje të lidhur me punësim pa autorizim.
- përdor kompjuterin e organizatës ose pajisjet e tjera për të shikuar, shkarkuar, krijuar ose shpërndarë materiale të papërshtatshme, të tilla si pornografia.

4. Unë do të kërkoj mbrojtjen e sigurisë dhe mirëqenies së vetvetes dhe të tjerëve:

Duke qenë i vetëdijshëm dhe në përputhje me politikën dhe praktikën lokale të SHVK për shëndetin dhe sigurinë dhe duke theksuar çdo fushë të shqetësimit tek menaxhmenti.

Unë nuk do të:

- sillem në asnjë mënyrë që shkakton rrezik të panevojshëm për veten ose të tjerët.

5. Unë do të mbroj mbroj asetet dhe burimet e SHVK

Duke i trajtuar burimet tona financiare dhe të tjera me kujdes. Unë do të siguroj që burimet e SHVK të mos keqpërdoren dhe do t'i mbroj nga vjedhja, mashtrimi dhe dëmtimi tjetër.

Unë nuk do të:

- jap për të tjerët asnjë informacion privat dhe konfidencial në lidhje me SHVK (ose për të cilin ne jemi përgjegjës), përveç nëse kërkohet ligjërisht për të vepruar ashtu.